

RREGULLORE NR. 2001/19

UNMIK/RREG/2001/19

13 shtator 2001

MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të ndryshuar, të datës 25 korrik të vitit 1999, mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të krijimit të një kornize kushtetuese për Qeverinë, e cila do të ushtrojë pushtetin ekzekutiv në kuadër të përgjegjësisë së institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes që do të ndërtohen përmes pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhjet e lira dhe të drejta,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

Neni 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1 Dega e Ekzekutivit në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të përbëhet nga Kryeministri dhe ministrat ("Qeveria") dhe ministrat nën autoritetin e tyre.

1.2 Kryeministri udhëheq Kabinetin e Kryeministrit, i cili ka statusin e ministrisë. Kabineti i Kryeministrit ndërlidhet me Kuvendin dhe koordinon punën e gjithë ministrave.

1.3 Secili ministër, në pajtim me politikën e përcaktuar nga Qeveria:

- (a) Udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;
- (b) I përgjigjet Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë e tij apo të saj;
- (c) Përcakton orientimin politik të punës së ministrisë;
- (d) Nxjerr vendime dhe udhëzime administrative në mënyrë që t'i rregullojë aktivitetet e ministrisë në përgjithësi ose në fushat e veçanta të ministrisë;
- (e) Kryen detyra të tjera në suaza të kornizës së përgjegjësisë të ministrisë të përcaktuara me ligj dhe

- (f) I raporton Kuvendit në mënyrë periodike, dhe me kërkesë të Kuvendit, raporton për aktivitetet e Ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të pranuar.

1.4 Secilit ministër mund t'i ndihmojnë më së shumti pesë këshilltarë të cilët e kanë statusin e të emëruarëve politikë dhe ata nuk mund të jenë anëtarë të Shërbimit Civil.

1.5 Çdo ministri do të ketë në stafin e vet anëtarë të tillë të Shërbimit Civil, duke përfshirë një sekretar të përhershëm, i cili do të shërbejë si zyrtar kryesor i saj në rast se kërkohet që t'i mundësohet ministrisë përmbushja e funksioneve të saj, ashtu siç është lejuar me buxhetin e institucioneve të vetëqeverisjes.

1.6 Çdo ministri, nën autoritetin e ministrit përkatës është përgjegjëse për zbatimin e politikës së Qeverisë në fushën përkatëse të kompetencave të veta. Nën autoritetin e ministrit përkatës, ministritë përgatisin akte legjislative dhe akte të tjera; bëjnë rekomandime të politikës së punës dhe zbatojnë legjislacionin në fuqi në fushat e kompetencës së vet. Ministritë mund të marrin udhëzime në këtë drejtim nga Qeveria, në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë ("Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme") dhe në pajtim me përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në këtë Rregullore për çdo ministri.

1.7 Gjatë kryerjes së përgjegjësiave dhe funksioneve të tyre, ministrat kujdesen që ministritë e tyre përkatëse:

- (a) Të formulojnë qartë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare që i vëhen në dispozicion nga Buxheti për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe burimet tjera;
- (b) Të sigurojnë ndarjen më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që i marrin nga Buxheti për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe burimet tjera;
- (c) Të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente dhe të përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejardhjes sociale, gjinore, paaftësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër;
- (d) Të krijojnë dhe të impletojnë masa kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe të nxisin vetëdijësimin kundër mashtrimit;
- (e) Të kujdesën për zhvillimin dhe mbajtjen e sistemeve, procedurave dhe proceseve adekuate për të ndihmuar funksionimin e ministrive;
- (f) Të krijojnë dhe aftësojnë kuadra në fushat e përgjegjësiave të tyre përkatëse;
- (g) Të hartojnë dhe implementojnë një sistem për menaxhimin e të dhënave, në mënyrë që të gjitha vendimet, politika dhe proceset e veprimit të mbështeten në një bazë të të dhënave të sakta, të plota dhe të përditësuara dhe
- (h) T'i shqyrtojnë nevojat e grupeve të rrezikuara dhe personave të tjerë brenda popullatës e cila mund të jetë e rrezikuar.

Neni 2

KABINETI I KRYEMINISTRIT DHE I MINISTRIVE TË TJERA

Kabineti i Kryeministrit

2.1 Kabineti i Kryeministrit ka një sektor që përfshin këshilltarët politikë në përbërje të të cilit janë zyrat e poshtëshënuara dhe, përveç kësaj, do të përfshijë zyrat e mëposhtme që bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje:

- (a) Zyra e shërbimeve për ndihmë juridike;
- (b) Zyra për informim publik;
- (c) Zyra këshilldhënëse për qeverisje të mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta dhe për çështje gjinore;
- (d) Zyra këshilldhënëse e komuniteteve dhe
- (e) Komisioni për emërimin e funksionarëve.

Ministritë e tjera

2.2 Ministritë që bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në shtojcat përkatëse të kësaj Rregulloreje janë:

- (a) Ministria për Ekonomi dhe Financa (Shtojca II);
- (b) Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë (Shtojca III);
- (c) Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (Shtojca IV);
- (d) Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve (Shtojca V);
- (e) Ministria e Shëndetësisë, e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (Shtojca VI);
- (f) Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (Shtojca VII);
- (g) Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (Shtojca VIII);
- (h) Ministria e Shërbimeve Publike (Shtojca IX) dhe
- (i) Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (Shtojca X).

Neni 3

AGJENCITË EKZEKUTIVE

3.1 Agjencitë e mëposhtme ekzekutive të themeluara me ligj veprojnë brenda ministrive të cilave u janë bashkëngjitur nën autoritetin e ministrit përkatës:

- (a) Autoriteti i Kosovës për Kontrollin e Barnave (Ministria e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor);
- (b) Zyra e Statistikës së Kosovës (Ministria e Shërbimeve Publike) dhe
- (c) Agjencia Kadastrale e Kosovës (Ministria e Shërbimeve Publike).

3.2 Agjencitë ekzekutive të specifikuar më lart si dhe agjencitë tjera që mund të themelohen me ligj, bartin përgjegjësitë dhe funksionet e përcaktuara në legjislacionin e hartuar. Buxheti i agjencive ekzekutive sigurohet nga ministria të cilës i janë bashkëngjitur ato.

3.3 Agjencinë ekzekutive e udhëheq kryeshefi ekzekutiv dhe kuadrat e saja duhet të jenë anëtarë të Shërbimit Civil.

Neni 4

PARIMET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT CIVIL

4.1 Do të ekzistojë një Shërbim i Përkohshëm Civil i Kosovës, që do të drejtohet sipas legjislacionit për rregullimin e Shërbimit civil.

4.2 Anëtarët e Shërbimit civil do të rekrutohen nga të gjitha komunitetet e Kosovës në bazë të kualifikimit të tyre profesional, kompetencave dhe meritës pas konkurrimit të drejtë dhe të hapur. Përfaqësimi i komunitetit pakicë në përbërjen e Shërbimit civil në të gjitha nivelet do të jetë proporcional me komunitetin pakicë në Kuvend.

4.3 Anëtarët e Shërbimit Civil kanë të drejtë t'u përkasin partive politike, sindikatave dhe organizatave të tjera, por duhet të përmbahen nga implikimi aktiv në aktivitetet politike.

4.4 Të gjithë anëtarët e Shërbimit Civil duhet t'i përmbahen Kodit të Shërbimit Civil.

Neni 5

SEKRETARËT E PËRHERSHËM TË MINISTRIVE DHE KRYESHEFAT EKZEKUTIVË TË AGJENCIVE EKZEKUTIVE

Emërimi

5.1 Sekretarët e përherëshëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive do të emërohen nga Komisioni për emërimin e funksionarëve. Këta zyrtarë duhet të jenë të ndershëm, kompetent dhe me përvojë për të udhëhequr resurset që bien në përgjegjësi të tyre.

5.2 Mënyra e emërimit dhe kushtet e shërbimit të sekretarëve të përhershëm të ministrive dhe kryeshefave ekzekutivë të agjencive ekzekutive do të përcaktohen në pajtim me ligjet që rregullojnë Shërbimet Civile.

5.3 Sekretarët e përhershëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive mund të shkarkohen nga pozita vetëm për shkak të keqadministrimit dhe moskompetencës profesionale, ose pas fajësimit për vepër penale dhe dënimit me burg prej gjashtë apo më tepër muajsh.

Funksionet dhe përgjegjësitë

5.4 Sekretarët e përhershëm të ministrive mbajnë përgjegjësi direkte ndaj ministrit përkatës. Kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive mbajnë përgjegjësi direkte ndaj ministrit përkatës apo autoriteteve tjera të përcaktuara me ligjin përkatës për themelimin e agjencive ekzekutive. Sekretarët e përhershëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive janë përgjegjës për:

- (a) Administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të ministrisë apo agjencisë ekzekutive dhe për sigurimin e implementimit të funksioneve që u janë besuar atyre;
- (b) Sigurimin e mbikëqyrjes adekuate, dhënien e këshillave të paanshme profesionale dhe të sakta për autoritetin përkatës mbi të;
- (c) Organizimin dhe punësimin e personelit për ministrinë apo agjencinë ekzekutive, si dhe nxjerrjen e urdhëresave administrative dhe vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të asaj ministrie;
- (d) Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë siguruar ministrisë apo agjencisë ekzekutive;
- (e) Implementimin e politikës jodiskriminuese për personelin e ministrisë apo agjencisë ekzekutive, duke përfshirë edhe përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin e përbërjes së personelit që reflekton karakterin multietnik të Kosovës dhe
- (f) Punësimin e personelit në ministri apo në agjencinë ekzekutive në bazë të kualifikimit profesional, aftësitë dhe meritat e secilit përmes konkursit të hapur dhe të drejtë.

5.5 Sekretari i përhershëm apo kryeshefi ekzekutiv, nuk merr udhëzime nga asnjë qeveri, organizatë, institucion apo person, përveç atyre që gëzojnë autoritetin e ministrisë apo agjencisë ekzekutive të tij apo të saj.

5.6 Sekretari i përhershëm apo kryeshefi ekzekutiv cakton një zyrtar të autorizuar financiar për ministrinë ose agjencinë ekzekutive të tij apo të saj dhe siguron harmoni të plotë me vendimet, urdhëresat administrative dhe rregullat financiare që janë nxjerrë përkitazi me këtë çështje nga Ministria për Ekonomi dhe Financa apo nga autoritetet tjera përkatëse.

Neni 6

MARRËVESHJET KALIMTARE

6.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të ndërmerr masa të tilla të nevojshme për rritjen e efikasitetit të Degës së ekzekutivit në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, duke përfshirë edhe marrëveshjet kalimtare për të lehtësuar kalimin e kompetencave dhe përgjegjësive mbi institucionet e tilla.

6.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të caktojë personel ndërkombëtar apo të tjerë në ministritë ose agjencitë ekzekutive për të përmbushur funksionet për të cilat ai mendon se janë adekuate dhe të nevojshme.

6.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimeve me Kryeministrin dhe me anëtarët përkatës të Qeverisë, mund t'i urdhërojë ministritë apo agjencitë ekzekutive të përmbushin funksione dhe detyra të kërkuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 7

AUTORITETI I PËRFAQËSUESIT SPECIAL TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

Ushtrimi i përgjegjësive që bie mbi Degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në pajtim me këtë rregullore në asnjë mënyrë nuk mund të ndikojë apo të zvogëlojë autoritetin suprem të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në zbatimin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë këtu edhe autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka autoritetin përfundimtar për interpretimin e fushëveprimit dhe parametrave të tjerë të përgjegjësive ekzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të përcaktuara me anë të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

IMPLEMENTIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë Urdhëresa Administrative për implementimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 9

HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 13 shtator 2001.

Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca I

Kabineti i Kryeministrit

Kryeministrit do t'i ndihmojë një sektor i cili përfshinë këshilltarë politikë sipas zgjedhjes së tij apo të saj. Ky sektor do të jetë përgjegjës për t'i ofruar ndihmë Kryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së Qeverisë dhe për koordinimin e punës së tij. Përveç tjerash, Kabineti i Kryeministrit përfshinë zyrat vijuese:

A. Zyra për shërbimet e ndihmës juridike

Zyra:

- (i) Ofron udhëheqje juridike, shërbime këshillimore dhe ekspertizë për Degën e ekzekutivit dhe për institucionet e tjera të vetëqeverisjes dhe
- (ii) Shqyrton të gjitha projektligjet që Dega e ekzekutivit ia dorëzon Kuvendit për të garantuar pajtueshmëri me ligjin në fuqi, me Zyrën këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, të drejtave të njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore, dhe Zyrën këshillëdhënëse për komunitete sipas rastit.

B. Zyra e informimit publik

Zyra:

- (i) Siguron transparencë dhe qasje publike për punën e Degës së ekzekutivit, duke u ofruar informata dhe dokumente opinionit publik dhe mediave;
- (ii) Informon publikun për punën dhe vendimet e Degës së ekzekutivit me anë të të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp;
- (iii) Kujdeset që pozita e Degës së ekzekutivit të përfaqësohet në shpalljet publike, në fushatat e informimit publik, në kumtesat e shtypit dhe në paraqitjen në media të anëtarëve të Degës së ekzekutivit përmes bashkërendimit me organet brenda Degës së ekzekutivit dhe
- (iv) Mban lidhje me shtypin lokal dhe ndërkombëtar për çështjet që i takojnë Degës së ekzekutivit.

C. **Zyra e këshilldhënies për qeverisje të mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe për çështjet gjinore**

Zyra:

- (i) Mbikëqyr dhe këshillon ministrat në sferat e qeverisjes së mirë, në të drejtat e njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore;
- (ii) Krijon politikën e veprimit dhe nxjerr urdhëresa në sferën e qeverisjes së mirë, në sferën e të drejtave të njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore;
- (iii) Shqyrton projektregulloret e përgatitura nga Dega e ekzekutivit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë, në bashkëpunim me Zyrën e shërbimeve për ndihmë juridike dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- (iv) Shqyrton politikën e veprimit të Degës së ekzekutivit, procedurat dhe praktikën e veprimit në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi, me praktikën e qeverisjes së mirë dhe mundësitë e barabarta dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me rrethanat;
- (v) Ndhmon në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe projekteve të tjera promovuese për të nxitur vetëdijësimin publik mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, transparencën e qeverisjes, barazinë gjinore, mundësitë e barabarta dhe parimet tjera bazë të qeverisjes demokratike;
- (vi) Konsultohet me përfaqësuesit e komunitetit dhe, sipas nevojës, krijon organe këshilldhënëse për shqyrtimin e qeverisjes së mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësitë e barabarta dhe për çështjet gjinore;
- (vii) Ndhmon zhvillimin e politikës së ndjeshme të barazisë gjinore dhe punon për avancimin e statusit të gruas në bashkëpunim me shoqërinë civile;
- (viii) Përcjell aktivitetet kundër mashtrimit dhe korrupsionit në Degën e ekzekutivit dhe nxit vetëdijësimin kundër mashtrimit;
- (ix) Përkrah vendimmarrjen demokratike dhe konsultimin e gjërë brenda Qeverisë;
- (x) Inkurajon pjesëmarrjen publike në qeverisje;
- (xi) Lëshon deklarata e rekomandime dhe
- (xii) Sipas nevojës, shqyrton dosjet dhe dokumentet e Qeverisë që janë në sferën e funksioneve dhe përgjegjësisive të zyrës, varësisht nga autorizimi i Kryeministrit.

D. Zyra këshilldhënëse e komuniteteve

Zyra:

- (i) Përcjell gjendjen e të drejtave dhe intereseve të komuniteteve dhe i rekomandon Qeverisë masa për shqyrtimin e problemeve të komunitetit;
- (ii) Në pajtueshmëri me dispozitat e Kapitullit 4 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe në bashkëpunim me Zyrën për shërbime të ndihmës juridike shqyrton projektligjet e përgatitura nga Dega e ekzekutivit dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrave përkatës në përputhje me rrethanat;
- (iii) Në pajtueshmëri me dispozitat e Kapitullit 4 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme shyrton politikën e veprimit të Degës së ekzekutivit, procedurat dhe praktikën e punës që kanë të bëjnë me shpërndarjen e barabartë të punëve në sektorin publik, në shërbimet publike dhe fondet publike të të gjitha komuniteteve dhe këshillon e i jep rekomandime Kryeministrit dhe ministrave përkatës në përputhje me rrethanat;
- (iv) Përcjell shqyrtimet dhe veprimin e Degës së ekzekutivit lidhur me rekomandimet dhe mendimet me shkrim të bëra nga Komiteti për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, që kanë të bëjnë me ligjet e propozuara dhe këshillon Kryeministrin dhe ministratë përkatëse;
- (v) Përcjell procedurat e filluara sipas paragrafit 9.1.39 dhe 9.1.40 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe i këshillon ministrat për çështjet lidhur me procedurat e tilla;
- (vi) Mban lidhje me komunat dhe organet joqeveritare për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komunitetit;
- (vii) Ndhmon zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe projektet tjera promovuese për ngritjen e vetëdijësimit mbi të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe
- (viii) Propozon udhëzime politike për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

E. Komisioni për emërimin e funksionarëve

Komisioni:

- (i) Organizohet dhe funksionon në pajtim me rregullat dhe procedurat e punës që do të përcaktohen në një Rregullore të mëvonshme;

- (ii) Kryesohet nga Kryeministri dhe për anëtarë të vet do të ketë:
 - (a) Ministrin e Shërbimeve Publike;
 - (b) Ministrin të cilit kandidati i emëruar do t'i shërbejë;
 - (c) Dy ministra nga komunitetet joshqiptare të Kosovës;
 - (d) Tre qytetarë eminentë të Kosovës që do t'i emërojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe
 - (e) Tre anëtarë ndërkombëtarë që do t'i emërojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm;
- (iii) Ka shërbime të sekretarisë që i siguron Ministria e Shërbimeve Publike;
- (iv) Emëron:
 - (a) Sekretaritetë e përhershme të ministrive;
 - (b) Nëpunësit kryesorë ekzekutivë të agjencive ekzekutive; dhe
 - (c) Individë në poste të tjera, për të cilat mund të vendosë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe
- (v) Në konsultim me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm i shkarkon zyrtarët e mësipërm për shkak të paaftësisë së tyre profesionale, sjelljes së keqe apo pasi të jenë shpallur fajtorë për ndonjë vepër penale dhe të jenë dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë apo më shumë muajve.

Shtojca II

Minsitria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria:

- (i) Koordinon zhvillimin dhe siguron realizimin e balancuar të buxhetit vjetor për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (ii) Krijon buxhete shumëvjeçare dhe programe afatgjata për investime publike në bashkëpunim me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (iii) Me institucionet përkatëse për vetëqeverisje të përkohshme dhe, sipas nevojës, me donatorët multilateralë dhe bilateralë koordinon çështjet që kanë të bëjnë me financimin nga donatorët dhe kontributet e dhuruara;
- (iv) Siguron përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve të donatorëve për qëllimet e dakorduara;
- (v) Kujdeset që të gjitha të ardhurat dhe burimet tjera të financimit nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, duke përfshirë dhe ndihmat financiare vullnetare, të regjistrohen sipas rregullave buxhetore;
- (vi) Me shërbimin doganor të UNMIK-ut koordinon çështjet administrative dhe operative;
- (vii) Kryen analiza ekonomike dhe punë kërkimore;
- (viii) Regjistron dhe iu raporton institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes si dhe Këshillit ekonomik dhe fiskal mbi të dalurat dhe të ardhurat e buxhetit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes;
- (ix) Përcjell harmonizimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes me rregullat në fuqi sa i përket shpenzimeve publike, duke përfshirë furnizimin pa paragjykim ndaj kompetencave të Zyrës së revizorit të përgjithshëm;
- (x) Përkrah aktivitetet kundër mashtrimit dhe korrupsionit në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, si dhe vetëdijësimin kundër mashtrimeve në përgjithësi dhe
- (xi) Në sektorin publik dhe privat siguron miratimin dhe zbatimin e standardeve të kontabilitetit në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare të kontabilitetit.

Shtojca III

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Minsitria:

- (i) Krijon kushte sistemore për tregti, industri dhe punë komerciale;
- (ii) Krijon politikën e punës dhe zbaton legjislacionin për përkrahjen e konkurrencës korrekte;
- (iii) Krijon politikën e punës dhe zbaton legjislacionin dhe programet për përkrahjen e ndërmarrjeve industriale dhe komerciale, veçmas ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- (iv) Krijon politikën e punës për zhvillimin e sektorit privat;
- (v) Krijon politikën e punës dhe zbaton programe për përkrahjen e tregtisë së jashtme;
- (vi) Krijon politikën e punës dhe zbaton legjislacionin për të ndihmuar turizmin në Kosovë;
- (vii) Përkrah investimet në Kosovë, veçmas përmes sigurimit të informatave për investitorët potencialë, duke i kundërvënë investitorët e huaj me ata të vendit, duke i ndihmuar investitorët në marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme dhe duke përpiluar e publikuar të dhënat mbi investimet e huaja;
- (viii) Jep rekomandime për çështjet e privatizimit;
- (ix) Krijon dhe përkrah programet për ruajtjen e energjisë;
- (x) Inkurajon zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e minierave dhe
- (xi) Administron sistemin e regjistrimit të biznesit.

Shtojca IV

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministria:

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë;
- (ii) Përkrah një sistem arsimor jodiskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve;
- (iii) Ofron arsim joformal dhe arsim për të rriturit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rajonet e largëta dhe përkrah mundësitë e shkollimit të përjetshëm për të gjithë;
- (iv) Përpilon, zbaton dhe mbikëqyr format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe menaxhimit shkollor;
- (v) Përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet;
- (vi) Ndhmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore;
- (vii) Përkrah hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës;
- (viii) Ndërton një sistem gjithëpërfshirës bibliotekar, i cili do të përfshijë bibliotekat e posaçme dhe ato shkollore;
- (ix) Përkrah një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave të paaftë dhe të hendikepuar; dhe
- (x) Përkrah pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkollë-komunitet në të gjitha nivelet.

Shtojca V

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ministria:

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për të përkrahur sektorin e kulturës, duke përfshirë programet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkrahjen e lidhjeve kulturore dhe formimin e klubeve kulturore, grupeve, shoqatave dhe shoqërive kulturore;
- (ii) Krijon politikën e veprimit dhe strategjitë për sektorin e rinisë, duke përfshirë identifikimin e grupeve specifike të rrezikuara, zhvillimin e programeve për shqyrtimin e nevojave të tyre dhe përkrahjen e klubeve, grupeve dhe shoqërive rinore;
- (iii) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për formimin dhe funksionimin e organizatave, shoqërive, klubeve dhe grupeve sportive;
- (iv) Kujdeset dhe ndihmon komunikimin dhe kontaktet mes personave dhe organizatave përmes aktiviteteve, siç janë zhvillimi, përhapja dhe këmbimi i materialeve informative, kulturore, arsimore dhe materialeve të tjera;
- (v) Përkrah aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore si dhe lidhjet me anëtarët e të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore, duke përfshirë edhe ata që jetojnë përkohësisht ose përgjithmonë në Kosovë (banorë jorezidentë); dhe
- (vi) Mban lidhje me rrjetat e themeluara të jorezidentëve, që trajtojnë nevojat kulturore të mërgimtarëve dhe të të kthyerve.

Shtojca VI

Ministria e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën dhe implementon ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor;
- (ii) Koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë dhe në lëmin e mbrojtjes së mjedisit për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi dhe mbrojtjen e mjedisit;
- (iii) Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjen e mjedisit duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
- (iv) Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- (v) Përcjell situatën e shëndetësisë dhe implementon masat adekuate për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë;
- (vi) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen e mjedisit në përgjegjësinë e kësaj ministrie;
- (vii) Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit;
- (viii) Krijon politikën, zbaton ligjet dhe mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin;
- (ix) Merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet shëndetësore dhe mbrojtjen e mjedisit;
- (x) Monitoron dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike, meqë ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- (xi) Inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor dhe të mjedisit për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- (xii) Krijon politikën për menaxhimin e resurseve të ujit dhe mbikëqyr implementimin e tyre;
- (xiii) Përkrah zhvillimin, implementimin dhe transferimin e teknologjive të pastra;

- (xiv) Në bashkëpunim me ministritë tjera përkatëse, identifikon fushat që duhet mbrojtur për të mirën e popullatës, krijon politikën dhe implementon masa për ruajtjen dhe administrimin e tyre;
- (xv) Siguron inkorporimin e planit hapësinor mbarëkosoar në politikën dhe programet e Qeverisë dhe mbikëqyr implementimin e tyre nga autoritetet përkatëse dhe
- (xvi) Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbikëqyr shërbimet e kontrollit të kualitetit të ushqimit dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Shtojca VII

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën e punës dhe mirëqenies sociale dhe implementon legjislacionin në këtë lëmi;
- (ii) Përkrah dhe zhvillon marrëdhëniet jodiskriminuese të punës duke marrë në konsiderim standardet e zbatueshme ndërkombëtare të punës;
- (iii) Përcjell gjendjen e punësimit dhe të mirëqenies sociale, propozon masa adekuate për të shtuar punësimin dhe për të zvogëluar papunësinë, si dhe për të përmbushur nevojat e ndihmës sociale;
- (iv) Përkrah politikën e veprimit dhe praktikën e punës dhe mirëqenies sociale për mbrojtjen e familjeve dhe të miturve;
- (v) Vendos standarde për siguri në punë dhe mbikëqyr implementimin e tyre;
- (vi) Udhëheq dhe mbikëqyr institucionet administrative të punës dhe të mirëqenies sociale, siç është Enti i Kosovës për Punësim, dhe bashkëpunon me komunat, zyrat e mirëqenies sociale dhe institucionet e përfshira në implementimin e politikës së punës dhe mirëqenies sociale;
- (vii) Siguron programe aftësimi për të papunësuarit dhe punëkërkuarit për të përmirësuar mundësitë e tyre të punësimit;
- (viii) Nxiti dialogun shoqëror dhe pjesëmarrjen e partnerëve shoqërorë në bashkëbisedime të tilla (sindikatat dhe punëdhënësit dhe organizatat e tyre) me komunitetet;
- (ix) Inkurajon zhvillimin e iniciativave dhe aktiviteteve të komunitetit përkitazi me punësimin dhe mirëqenien sociale;
- (x) Konvokon mbledhjen tripalëshe këshillëdhënëse të institucioneve të vetëqeverisjes së përkohshme dhe të organizatave të punëdhënësve e punëtorëve për konsultime rreth punës, për mirëqenie sociale dhe politika të tjera ekonomike dhe përfaqëson institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në këtë mbledhje;
- (xi) Siguron ndihma financiare nga mjetet e akorduara për familjet dhe individët nevojtarë;
- (xii) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me punën dhe mirëqenien sociale në përgjegjësinë e kësaj ministrie; dhe
- (xiii) Përkrah zhvillimin e sistemit të sigurimit social, duke përfshirë edhe papunësinë dhe sigurimin pensional.

Shtojca VIII

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën e punës dhe implementon ligjet për sigurimin e shërbimeve dhe objekteve në sektorin e transportit rrugor; transportit publik rrugor, postës, telekomunikacionit dhe teknologjisë informative;
- (ii) Identifikon dhe vendos kritere, specifika teknike dhe standarde të zbatueshme adekuate në pajtim me ofruesit e shërbimeve dhe infrastrukturën; mbikëqyr këtë punë dhe nëse është e nevojshme bën inspektimin dhe kontrollimin dhe informon për pasojat e mospërbushjes së këtyre kushteve;
- (iii) Mbikëqyr dhe përcjell punën e sektorëve dhe prezenton masa adekuate për të tejkaluar vështirësitë dhe problemet e shërbimeve;
- (iv) Krijon politikën e punës dhe propozon programe për promovimin e ndërmarrjeve nëpër sektorë, duke përfshirë edhe strategjitë për rindërtim dhe investime kapitale;
- (v) Merr pjesë në zhvillimin e fushatave për informim publik dhe të projekteve të tjera përkrahëse për të ngritur vetëdijësimin publik dhe reagimin ndaj çështjeve sektoriale;
- (vi) Në sektorin e telekomunikacionit shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që pëfshijnë tarifrat dhe taksat, cilësinë e shërbimeve dhe të standardeve teknike; krijon politikën e punës për promovimin e konkurrencës dhe shqyrton nevojat e konsumatorëve;
- (vii) Në sektorin e postës shqyrton pajtueshmërinë me standardet evropiane që përfshijnë tarifrat, cilësinë e shërbimeve dhe standardet teknike;
- (viii) Në sektorin e teknologjisë informative përkrah teknologjinë informative dhe të inovacioneve, p.sh. tregtinë elektronike, përkrah qasjen në teknologji dhe nxit zhvillimin e sistemeve të aftësisimit në teknologjinë informatikës;
- (ix) Në sektorin e infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, siguron financimin dhe organizon dhënie të koncesioneve sipas nevojës; mbikëqyr financimin dhe menaxhimin e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe zhvillimore përkitazi me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike, kontrollojnë gjendjen e rrugëve, si dhe mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor;
- (x) Në sektorin e transportit rrugor të personave dhe mallrave mbikëqyr procedurat e licencimit të ndërmarrjeve, automjeteve dhe shoferëve; u jep autorizime operative (itinerarin dhe intervalin kohor) në bazë të konkurrencës dhe mbështet sigurimin e shërbimeve humanitare dhe shërbimeve tjera speciale dhe

- (xi) Mbikëqyr sigurinë e transportit, ndërmarrjen e aksioneve dhe hetimeve të nevojshme dhe siguron që rreziku për jetë dhe dëmet tjera të zvogëlohen.

Shtojca IX

Ministria e Shërbimeve Publike

Kjo Ministri:

- (i) Zhvillon dhe mbikëqyr implementimin e politikës së punës për një Shërbim civil shumetnik, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm;
- (ii) Zhvillon dhe koordinon implementimin e politikës së punës për krijimin dhe aftësimin e kuadrave për Shërbimin civil;
- (iii) Administron sistemin e pagesave dhe listën e pagave të Shërbimit civil;
- (iv) Siguron shërbime të inxhinierisë dhe menaxhimit të ndërtesave për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (v) Vendos standardet dhe shërbimet e teknologjisë informative që duhet përdorur nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe koordinon sigurimin e shërbimeve të teknologjisë informative në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes;
- (vi) Zhvillon dhe mbikëqyr implementimin e politikës së punës për sigurimin e shërbimeve të furnizimit në pajtim me rregullat dhe procedurat e Ministrisë për ekonomi dhe financa;
- (vii) Ndhmon në administrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit të regjistrimit qendror civil dhe bazës së të dhënave;
- (viii) Ndhmon në administrimin e politikës së punës përkitazi me dokumentet civile, regjistrimin e automjeteve dhe OJQ-ve;
- (ix) Mbikëqyr mbledhjen, mirëmbajtjen, analizat dhe publikimin e statistikave zyrtare;
- (x) Kryen funksione në lëmin e administratës lokale në pajtim me paragrafin 5.2 të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme;
- (xi) Kryen funksione në lëmin e çështjeve gjyqësore në pajtim me paragrafin 5.3 (b) – (m) të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme; dhe
- (xii) Kryen funksione në lëmin e përgatitjeve civile për raste emergjente në pajtim me paragrafin 5.5 të Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisje.

Shtojca X

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kjo Ministri:

- (i) Krijon politikën dhe zbaton ligjet për zhvillimin e bujqësisë, duke përfshirë edhe bagëtinë dhe prodhimin e bimëve, zhvillimin rural dhe vendosjen e standardeve për mirëmbajtje;
- (ii) Lehtëson zhvillimin e skemës kreditore për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat;
- (iii) Krijon politikën për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetëmbajtjen, luftimin nga zjarri, parandalimin e zjarrit, dezinfektimin nga insektet dhe sëmundjet e ndryshme, licencimin për prerjen e drunjve dhe kontrollimin e gjuetisë dhe peshkimit;
- (iv) Rregullon aktivitetet e gjuetisë dhe peshkimit;
- (v) Mbikëqyr ofrimin e shërbimeve veterinare, duke përfshirë ndër të tjera parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, të zoonozës dhe përmirësimin e cilësisë së kopeve dhe tufave të shpezëve;
- (vi) Krijon politikën në lëmin e ujitjes, duke përfshirë edhe projektet për planifikimin e ujitjes;
- (vii) Krijon politikën dhe zbaton ligjet përkitazi me shfrytëzimin e tokës bujqësore me qëllim të mbrojtjes së saj;
- (viii) Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr zbatimin e standardeve shëndetësore që ndërlidhen me bujqësinë, pylltarinë, qendrat për rritjen e peshqve dhe zhvillimin rural;
- (ix) Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve;
- (x) Mbikëqyr aktivitetet që synojnë zhdukjen e insekteve, parazitëve, sëmundjeve të bimëve apo shkaktarëve të tjerë destruktive;
- (xi) Merr pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit që kanë të bëjnë me bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkimin dhe menaxhimin e resurseve të ujit dhe
- (xii) Ofron ndihmë në çështjet që ndërlidhen me veterinarinë, bën kontrollin fotosanitar dhe të cilësisë së shtazëve dhe produkteve shtazore që kalojnë tranzit nëpër vendkalimet kufitare administrative dhe shtetërore të ushqimit dhe lëndës së parë bujqësore, të bimëve dhe produkteve bimore.